

SKEMA E ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Cilat janë institucionet përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil?

1

Këshilli i Ministrave është institucioni që miraton aktet nënligjore në bazë dhe për zbatim të ligjit për nëpunësin civil; miraton mënyrën e organizimit dhe funksionimit të institucioneve që përgjigjen për formimin profesional të nëpunësve civilë dhe i raporton Kuvendit çdo vit për politikën në shërbimin civil dhe zbatimin e tyre.

2

Shërbimi civil administrohet nga **Departamenti i Administratës Publike** në institucionet e administratës shtetërore dhe nga njësitë e burimeve njerëzore në institucionet e administratës vendore që janë Bashkitë dhe Këshillat e Qarkut dhe institucionet e pavarura, që janë institucionet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj të veçantë.

Departamenti i Administratës Publike mbikëqyr zbatimin e legjisllacionit të shërbimit civil nga njësitë e burimeve njerëzore në institucionet e administratës shtetërore dhe harton politikën e shërbimit civil.

3

Komisioneri për **Mbikëqyrjen e Shërbimit civil**, është institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë: në administratën shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetqeverisjes vendore.



SKEMA E ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL



04 22 68 141



kmshc@kmshc.al



Rruga "Abdi Toptani",
ish-hotel "Drini",
Tiranë



kmshc23@gmail.com